



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
“ISA BOLETINI”

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Nr. Prot. 477/005 Dt 04.04.2017

THIRRJE

Për shprehjen e interesit për monitorim – vëzhgim të zgjedhjeve të studentëve në Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini” 2017.

- I. Në bazë të nenit 11, pika 4 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve, Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini”, u bënë thirrje të gjitha institucioneve, organizatave dhe palëve tjera për shprehje të interesit për monitorim të gjithë procesit të zgjedhjeve të studentëve të shpallura me vendimin e KD të UMIB – it dhe që do të mbahen me datë 24.04.2017.

Shprehja e interesit për monitorim të zgjedhjeve nga institucionet, organizatat dhe palët e tjera, bëhet në formë të shkruar dhe dorëzohet në zyrën ligjore të Universitetit të Mitrovicës. Aplikimi për monitorim duhet të përmbaj: Emrin e institucionit; dëshmi se është person juridik; emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar për monitorim; numri kontaktues dhe e – mail adresa.

- II. Në pajtim me neni 16 të Rregullores për zgjedhjet e studentëve “Secila organizatë e studentëve që kualifikohet për pjesëmarrje në zgjedhjet e studentëve sipas kësaj rregulloreje, dhe e cila nuk është e përfaqësuar në komisionin zgjedhor apo në komisionet e fakultetit, ka të drejtë të nominojë një vëzhgues në komisionin zgjedhor”. Në kuptim të nenit 16 ftohen organizatat studentore që të nominojnë vëzhgues në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe në Komisionet zgjedhore të fakulteteve.

Aplikimi për monitorim – vëzhgim të zgjedhjeve të studentëve bëhet me datë 11.04.2017, kurse certifikimi do të bëhet nga KQZ me datë 12.04.2017.

Universiteti i Mitrovicës është i përkushtuar për një proces të rregullt zgjedhor, transparent dhe korrekt.

Ju mirëpresim

